

VAKSINIME PËR TË GJITHË

Vaksinat kundër COVID-19 për fëmijë

Pyetje të shpeshta për prindërit dhe kujdestarët

Si t'ia bëj vaksinën kundër COVID-19 fëmijës tim?

Ka disa mënyra si mund t'ia bëni vaksinën kundër COVID-19 fëmijës tuaj. Inkurajohen takimet për vaksinimet pediatrike. Mund të lini një takim duke:

- + I telefonuar pediatri tuaj
- + I telefonuar nr. 1-877-VAX-4NYC (1-877-829-4692)
- + Përdorur funksionin e gjetjes së pikave të vaksinimit për qytetin e Nju-Jorkut, NYC Vaccine Finder në vaccinefinder.nyc.gov, që përfshin farmacitë, qendrat shëndetësore të lagjeve, klinikat e vaksinimit në administrimin e qytetit dhe furgonët dhe autobusët ambulantë të vaksinimit
- + Kërkuar vaksinim në shtëpi në faqen forms.cityofnewyork.us/f/home. Inkurajohen takimet për vaksinimet pediatrike. Pranohen rase të kufizuara pa takim. Ju lutemi, planifikoni një takim për vaksinimin e fëmijës suaj në faqen covid19.nychealthandhospitals.org/COVIDVaxEligibility dhe kontaktoni me një prej spitaleve tona nëse keni pyetje për disponueshmërinë e vaksinave pediatrik.

Merrni më shumë informacion se ku të vaksinoheni në faqen vaccinefinder.nyc.gov ose telefononi në nr. 877-829-4692.

Cilën vaksinë ofron NYC Health + Hospitals për fëmijët nën 5 vjeç?

NYC Health + Hospitals ofron vaksinën kundër COVID-19 të Pfizer për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç.

Përse duhet ta bëjë fëmija im vaksinën kundër COVID-19?

COVID-19 mund të jetë i dëmshëm te fëmijët, pasi mund t'i sëmurë rëndë. Fëmijët që sëmuren rëndë mund të kenë nevojë për shtrim në spital ose të përballen me probleme shëndetësore afatgjata, si p.sh. dhimbje muskujsh apo vështirësi me frymëmarrjen, deri dhe vdekjen. COVID-19 është një nga 10 shkaqet kryesore të vdekjeve te fëmijët në SHBA. Mënyra më e mirë për të mbrojtur fëmijën tuaj nga COVID-19 është që ta vaksinoni.

Vaksina është e sigurt dhe tejet efikase në parandalimin e sëmurjes nga COVID-19 te fëmijët e moshave 6 muajsh deri 17 vjeç. Fëmijët që bëjnë vaksinën kanë më pak gjasa të infektohen dhe të përhapin COVID-19. Vaksinimi i fëmijës suaj kundër COVID-19 ndihmon dhe në mbrojtjen e familjes dhe të komunitetit tuaj.

A është e sigurt vakcina kundër COVID-19 për fëmijët e vegjël?

Po! Vakcina kundër COVID-19 e Pfizer është testuar në mijëra fëmijë të moshave 6 muajsh deri 17 vjeç, dhe është shumë e sigurt dhe efikase. Asnjë prej këtyre fëmijëve nuk ka pësuar efekte të rënda anësore.

Agjencia e Ushqimeve dhe e Barnave e SHBA-së e ka vrotuar procesin e testimin nga afër. Agjencia për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve dhe ekspertë të tjerë vijnë të monitorojnë për probleme sigurie të fëmijët që kanë kryer vaksinën kundër COVID-19.

Sa doza të vaksinës kundër COVID-19 ka nevojë fëmija im që të jetë plotësisht i vaksinuar?

Fëmijët e moshës 6 muajsh deri 4 vjeç duhet të marrin tri doza të vaksinës kundër COVID-19 të Pfizer. Dozat e parë dhe e dytë ndahen nga tri javë dhe dozat e dytë dhe e tretë ndahen nga tetë javë.

Fëmijët e moshave 5 deri 11 vjeç duhet të kryejnë dy doza të vaksinës kundër COVID-19 të Pfizer, me tri javë diferencë. Fëmija juaj konsiderohet plotësisht i vaksinuar dy javë pas dozës së dytë. Fëmijët 5 vjeç e lart me imunitet të cenuar duhet të kryejnë një dozë shtesë të paktën 28 ditë pas dozës së tyre të dytë të Pfizer (për tri doza gjithsej) si pjesë të serisë së tyre primare.

A është vakcina kundër COVID-19 për fëmijët e njëjtë me vaksinën për të tjerët?

Vakcina kundër COVID-19 nga Pfizer për fëmijët e moshave 6 muajsh deri 4 vjeç është 3 mikrogramë, një e dhjeta e dozës së adoleshentëve dhe të të rriturve. Vakcina kundër COVID-19 nga Pfizer për fëmijët e moshave 5 deri 11 vjeç është 10 mikrogramë, që është një e treta e dozës së adoleshentëve dhe të të rriturve. Studiuesit kanë konstatuar se këto doza të ulura kanë sjellë më pak efekte anësore të fëmijët e vegjël dhe ka qenë po aq efikase në parandalimin e COVID-19 sa doza e lartë.

A do të kenë efekte anësore fëmijët e mi nga vakcina kundër COVID-19?

Efektet anësore nga vakcina kundër COVID-19 nga Pfizer të fëmijët e moshave 6 muajsh deri 17 vjeç janë zakonisht të lehta. Ato nuk janë aq të zakonshme apo të pakëndshme sa efektet anësore tek adoleshentët dhe të rriturit. Fëmijët mund të ndiejnë pak dhimbje kur vaksinohen, ashtu si me çdo vaksinë tjetër. Më pas mund të kenë dhimbje krahu dhe mund të ndihen të lodhur apo me dhimbje, të kenë dhimbje koke apo temperaturë. Të gjitha këto janë shenja që trupi po krijon mbrojtje kundër COVID-19. Efektet anësore zakonisht largohen pas një ose dy ditësh.

A do të jetë në rrezik fëmija im pas kryerjes së vaksinës kundër COVID-19, si p.sh. probleme me zemrën?

Nuk ka fakte se vakcina e Pfizer kundër COVID-19 shkakton probleme afatgjata me shëndetin. Mund të ketë një rrezik shumë të ulët inflamacioni të zemrës të fëmijët e moshave 5 deri 11 vjeç që kryejnë vaksinën kundër COVID-19, por nuk ka pasur raste inflamacioni në provën klinike mes fëmijëve të moshave 5 deri 11 vjeç. Nga pak rastet e hasura tek adoleshentët e moshave 12 deri 17 vjeç shumica kanë qenë të lehta dhe janë përmirësuar me barna me recetë dhe regjim shtrati. Në fakt, rreziku i problemeve afatgjata me zemrën është shumë më i lartë nëse fëmija juaj sëmuret me virusin që shkakton COVID-19.

A do të ndikojë vakcina kundër COVID-19 te fertiliteti i fëmijës tim?

Nuk ka fakte se vakcina e Pfizer kundër COVID-19 shkakton probleme me fertilitetin. Agjencia për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve dhe ekspertë të tjerë shëndetësorë rekomandojnë që njerëzit që mund të duan të bëjnë fëmijë të vaksinohen.

Fëmija im e ka kaluar COVID-19 dhe tani është më mirë. A duhet ta vaksinoj gjithsesi?

Vakcina e Pfizer kundër COVID-19 rekomandohet për të gjithë fëmijët që përmbushin kriteret pavarësisht nëse e kanë kaluar apo jo COVID-19. Studimet tregojnë se njerëzit e vaksinuar plotësisht janë më të mbrojtur kundër COVID-19 se ata që janë shëruar prej tij. Ne gjithashtu nuk e dimë sa zgjat mbrojtja kundër COVID-19 pas shërimit prej tij. Vaksinimi i fëmijës suaj është mënyra më e mirë për ta mbrojtur nga risëmurja me COVID-19.

Fëmija im së shpejti bëhet 12 vjeç. A të pres që ta vaksinoj me dozë më të lartë?

Ne rekomandojmë ta vaksinoni fëmijën sa më shpejtë jetë e mundur.

Nëse fëmija im është 4 vjeç kur bën dozën e parë dhe bëhet 5 vjeç përpara bërjes së dozës së dytë ose të tretë, OSE nëse fëmija ime është 11 vjeç kur bën dozën e parë dhe bëhet 12 përpara bërjes së dozës së dytë, a do të bëjë në këtë rast dozë më të lartë?

Po. Doza e vaksinës do të bazohet në moshën e fëmijës suaj në çastin kur ky bën vaksinën, por ka fleksibilitet me zgjedhjen e dozës më të ulët.

A mund ta bëjë fëmija im vaksinën kundër COVID-19 njëherësh me vaksinat e tjera, si vakcina kundër gripit?

Po. Agjencia për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve rekomandon kryerjen e vaksinës kundër COVID-19 dhe të vaksinave të tjera - duke përfshirë vaksinën kundër gripit - në të njëjtën kohë. Nuk ka nevojë të prisni ndërmjet vaksinave.

A mund të sëmuret fëmija im me COVID-19 edhe pasi është vaksinuar plotësisht?

Nëse fëmija ekspozohet ndaj virusit që shkakton COVID-19 pas vaksinimit të plotë, ka një mundësi të vogël që të infektohet. Por vakcina është tejet e efikase në parandalimin e sëmundjes së rëndë, nevojës për shtrim në spital, komplikacioneve afatgjata dhe vdekjes. Ka gjithashtu më pak gjasa që fëmija juaj ta përhapë virusin nëse vaksinohet.

A kërkohet vakcina kundër COVID-19 që fëmija im të ndjekë shkollën?

Ne rekomandojmë së tepërmi që ta vaksinoni fëmijën kundër COVID-19 për ta mbajtur atë dhe shokët e tij të klasës të shëndetshëm. Për momentin vakcina nuk është e domosdoshme për të ndjekur shkollat publike. Shkollat private, çerdhet dhe kampet mund ta kërkojnë, ndaj është mirë të kontrolloni për rastin tuaj. Kryerja e vaksinës kundër COVID-19 e bën më të sigurt për fëmijën tuaj qenien në klasë, pjesëmarrjen në aktivitetet passhkollore dhe sporte, si dhe mbledhjen me shokët.

A rekomandohen vaksinat përforcuese për fëmijët?

Për momentin të gjithë personat 5 vjeç e lart inkurajohen të bëjnë një injeksion përforcues. Personat 5-17 vjeç që kanë bërë më parë serinë primare të Pfizer mbi pesë muaj më parë përfitojnë vetëm injeksionin përforcues të Pfizer. Fëmijë të caktuar me imunitet të cenuar të moshës 5-11 vjeç mund të marrin një dozë shtesë të vaksinës së Pfizer 28 ditë pas injeksionit të dytë. Fëmijët nga 5 vjeç e lart dhe me imunitet të cenuar duhet të bëjnë një injeksion përforcues të paktën tri muaj pas bërjes së dozës shtesë serisë primare të vaksinës kundër COVID-19 nga Pfizer (për katër doza gjithsej). Flisni me mjekun e kujdesit primar të fëmijës suaj për të mësuar më shumë.

Fëmija im ka sistem të dobësuar imunitar. A do ta mbrojë vakcina kundër COVID-19?

Agjencia për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve rekomandon vaksinën e Pfizer për fëmijët me sistem të dobësuar imunitar pasi ka më shumë gjasa të sëmuren rëndë nëse pësojnë COVID-19. Edhe pas kryerjes së vaksinës, njerëzit me sistem të dobësuar imunitar janë më pak të mbrojtur se të tjerët që janë të vaksinuar. Kur më shumë njerëz janë të vaksinuar në një komunitet, personat me sistem të dobësuar imunitar - duke përfshirë fëmijët - mbrohen më mirë nga COVID-19. Prandaj është e rëndësishme që sa më shumë njujorkezë të vaksinohen. Fëmijë të caktuar me imunitet të cenuar të moshës 5-11 vjeç mund të marrin një dozë shtesë të vaksinës së Pfizer 28 ditë pas injeksionit të dytë.